



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Prishtinë, 15.10. 2021

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 30, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, neni 33, paragrafi 5, neni 51 dhe 52, udhëzimit administrativ Nr.07.2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencor dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë shpallë:

K O N K U R S

1. Një Hulumtues të pavarur për fundin e shek. XX -zgjedhje-rizgjedhje

Kandidatët për pozitën Hulumtues i pavarur duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të ketë të regjistruara studimet e doktoraturës,
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore nga periudha e caktuar,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse,
- Vërtetimin me të cilin dëshmohet që është duke vijuar studimet e doktoratës,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.

Zgjedhja e personelit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore, dhe Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri".

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512 - 303, prej orës 08:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, rr. “Muharrem Fejza”, pa numër (Ndërtesa e Arkivit të Kosovës).